



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV**

**Nr. 27 i Regj. Themeltar
Nr. 27 i Vendimit**

**V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Sokol SADUSHI -Kryesues
Sokol NGRESI -Anëtar
Gentian MEDJA -Anëtar**

sot, më datën 01.11.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, kërkesën administrative me nr. 31003-00027-00-2022 akti që i përket:

KËRKUES: Jorgo Zaro
Enida Zaro

OBJEKTI: Konstatimin e cenimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyqimit të ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, brenda afatit të arsyeshëm, të përcaktuar nga neni 471/a i Kodit të Procedurës Civile. Përshpejtimin e procedurave për gjykimin e çështjes. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin e ankimit brenda 30 ditëve.

BAZA LIGJORE: Neni 6/1 Konventa Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Neni 399/ 1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Jorgo Zaro
Enida Zaro
Dashamira Zaro

E PADITUR: Bashkia Sarandë

OBJEKTI:

Urdhërimin e Bashkisë Sarandë për përfundimin e procedurave për kalimin e pronësisë për truallin, e përfituar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. 1, datë 28.08.1999, ose të paguaj dëmin pasuror dhe jopasuror, për shkak të moskalimit në pronësi të truallit të blerë, brenda 30 ditëve nga data që vendimi do të marrë formë të prerë.

BAZA LIGJORE:

Neni 15/ a, 17/ ç të ligjit 49/ 2012 i ndryshuar. Neni 104 i Kodit të Procedurave Administrative. Neni 625 i Kodit Civil. Ligji nr. 8510/ 1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”. VKM nr. 329, datë 22.5.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me agjencinë shtetërore të kadastrës, për regjistrim e trojeve të dhëna në ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi

V Ë R E N:**I. Rrethanat e çështjes,**

1. Nga aktet e administruara rezulton se, paditësat Jorgo Zaro etj, i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me padinë me objekt; *“Urdhërimin e Bashkisë Sarandë për përfundimin e procedurave për kalimin e pronësisë për truallin e përfituar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. 1, datë 28.08.1999, ose të paguaj dëmin pasuror dhe jopasuror, për shkak të moskalimit në pronësi të truallit të blerë, brenda 30 ditëve nga data që vendimi do të marrë formë të prerë”*.

2. Gjatë zhvillimit të procesit rezulton se, më datë 21.01.2021 prej paditësave Jorgo Zaro, Enida Zaro dhe Dashamira Zaro është paraqitur *“Kërkesë”*, me objekt *“Përjashtimi i (1) Dashamira Zaro, (2) Jorgo Zaro, (3) Enida Zaro nga pagimi i tarifave gjyqësore, shpenzimeve gjyqësore dhe nga detyrimi për parapagim të tarifave të vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit”*

3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë**, me vendimin nr. s’ka, datë 23.03.2021, ka vendosur:

“Refuzimin e kërkesës së paditësve Jorgo Zaro, Dashamira Zaro dhe Enida Zaro për përjashtim nga pagimi i tarifave të përgjithshme e të veçanta, pagimin e shpenzimeve gjyqësore, në çështjen administrative regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me nr. 237 akti, datë 01.03.2021 regjistrimi”.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendim, datë 08.09.2021 ka vendosur:

“Pezullimin e gjykimit të çështjes deri në përfundim të shqyrtimit të ankimit të paraqitur nga pala paditëse Jorgo Zaro, Enida Zaro në Gjykatën Administrative të Apelit për përjashtimin nga pagimi i të gjitha tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore.”

5. Kundër vendimit të ndërmjetëm nr. s’ka, datë 23.03.2021 të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, kanë paraqitur **ankim** palët paditëse (kërkues), Jorgo Zaro, Enida Zaro, (si edhe paditësja Dashmira Zaro më datë 08.04.2021) dhe aktualisht çështja objekt gjykimi ndodhet pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe është në pritje të gjykimit.

6. Me datë 21.09.2021 paditësit (kërkues) Jorgo Zaro dhe Enida Zaro kanë paraqitur përpara Gjykatës së Apelit, ardhur në Gjykatën e Lartë me datë 30.09.202 “kërkesë” me objekt *“Përsheptimin e gjykimit të ankimit kundër vendimit të ndërmjetëm nr. s’ka, datë 23.03.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër”*, ku ndër të tjera është parashtruar;

- Konform nenit 471 të KPrC ankimi i veçantë duhet të gjykohet brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit në Gjykatën e Apelit, ndërkohë rezulton se kanë kaluar rreth 16 muaj dhe ende ankimi nuk është shqyrtuar, duke shkelur në këtë mënyrë çdo afat të arsyeshëm
- Në kushtet që, mosgjykimi i ankimit është bërë shkak për pezullimin e gjykimit në shkallë të parë, sipas parashikimeve të Kreu II, pika 6, gërma “c” të vendim nr. 78, datë 30.05.2019 e KLGj-së, përbën shkak veçanërisht të rëndë dhe të motivuar për përsheptimin e gjykimit të çështjes. Kërkojmë, pranimin e kërkesës sipas objektit dhe njoftim për fatin e kësaj kërkesë.”

7. Në përputhje me nenin 399/4, pika 1, e Kodit të Procedurës Civile, me shkresën me nr. 5217 prot., datë 05.10.2022 të Kancelarit të Gjykatës së Lartë është kërkuar informacion nga gjyqtari relator në lidhje me fazën dhe procedurat e gjykimit të kësaj çështje.

8. Në informacionin e parashtruar nga gjyqtari relator i çështjes, me shkresën nr. 1530/1 prot., datë 11.10.2022, ai është shprehur se, për këtë çështje jam caktuar me shortin e datës 03.06.2022. Në dosjen gjyqësore nuk kam asnjë kërkesë për përsheptimin e gjykimit, e cila të më drejtohet mua si gjyqtar relator i çështjes. Sipas nenit 399/ 2 pika 1, gërma a “Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/ 1, do të konsiderohen: a) në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Megjithatë çështja është planifikuar në Dhomë Këshillimi për në datë 02.11.2022 ora 12:10. Gjithashtu se aktualisht kam si relator një ngarkesë prej 3877 dosjesh.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

9. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) konstaton se kërkesa është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar. Kërkuesit Jorgo Zaro dhe Enida Zaro rezulton të jenë në cilësinë e palës paditëse në procesin gjyqësor për të cilin është regjistruar ankimi me nr. regjistri themeltar 31136-01595-86-2020, datë 10.05.2021 në Gjykatën Administrative të Apelit.

10. Kërkesa është në kompetencën e këtij Kolegji, sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja b), të Kodit të Procedurës Civile, pasi përmes saj kërkohet konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Kërkesa i plotëson elementët e parashikuar në nenin 399/5, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile si dhe është e shoqëruar me 3 të gjitha aktet e tjera të nevojshme, të përcaktuara në nenin 399/5, pika 2, të Kodit të Procedurës Civile

11. Kolegji vlerëson se parimi i gjykimit brenda afatit të arsyeshëm ka një rëndësi themelore për gjykimin civil/administrativ, pasi përbën dhe një nga elementët e procesit të rregullt ligjor të

parashikuar në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky parim bazohet në postulatit “*Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*”. Shkalla e respektimit të këtij parimi përcakton në mënyrë të ndjeshme dhe efektivitetin e procesit gjyqësor. (*Shih vendimin H. kundër Francës, datë 24.10.1989 të GJEDNJ*)

12. Kolegji çmon të theksojë se praktika e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ), e cila ka përcaktuar se periudha e afatit të arsyeshëm për përfundimin e një procesi gjyqësor civil shtrihet, që nga momenti i ngritjes së padisë tek momenti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor. (*shih vendimin Qufaj kundër Shqipërisë; Vendimin Scopelliti kundër Italisë, datë 23.11.1993 të GJEDNJ*). Gjykata ka një pozitë kryesore dhe të veçantë, pasi është i vetmi organ që është përgjegjës për dhënien e drejtësisë dhe si e tillë merr pjesë në mënyrë të detyrueshme në të gjitha marrëdhëniet që krijohen gjatë gjykimit të çështjes.

13. Në vijim, të jurisprudencës së konsoliduar GJEDNJ ka identifikuar disa elemente përbërëse të këtij standardi. Në referim të saj, rezulton se në përlllogaritjen e afatit të arsyeshëm merren në konsideratë faktorë të ndryshëm, të tilla si: kompleksiteti i çështjes; sjellja e palëve ndërgjyqëse; sjellja e autoriteteve gjyqësore dhe administrative. (*Shih vendimin Buchholz kundër Republikës Federale Gjermane datë 06.05.1981 dhe Bjeliç kundër Sllovenisë ap. nr. 50719/06, datë 18.10.2012. të GJEDNJ*)

14. Kolegji vlerëson se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes, merr në konsideratë të gjithë faktorët dhe elementet që kanë të bëjnë me çështjen, natyrën e interesave të përfshira në të, rëndësinë e fakteve, rëndësinë e zgjidhjes ligjore, numri i personave të akuzuar dhe i dëshmitarëve, elementet ndërkombëtarë, lidhja e çështjes me çështje të tjera dhe ndërhyrja e personave të tjerë në procedure. (*Shih vendimin Trggiani kundër Italisë datë 19.02.1991; Manieri kundër Italisë dt. 27.02.1992, Stefancic kundër Sllovenisë, datë 25.10.2012 të GJEDNJ*)

15. Për sa i përket sjelljes së kërkuesit, Kolegji vlerëson se ky kriter lidhet me mënyrën se si janë sjellë palët në proces ndaj procedimit. Diligjencën e treguar prej tyre për përfundimin e procesit, pengesat që ato kanë krijuar dhe faktorë të tjerë që janë të lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Megjithatë, kjo duhet vlerësuar rast pas rasti vlerëson gjykata, pasi një person nuk është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet proceduese në mënyrë aktive për të përshpejtuar procedurat gjyqësore që çojnë në dënimin e tij. (*shih vendimin Eckkle kundër Republikës Federale Gjermane, dt. 15.07.1982 të GJEDNJ*)

16. Kolegji vlerëson se për sa i përket sjelljes së autoriteteve për vlerësimin e kohëzgjatjes së afatit të arsyeshëm të gjykimit, GJEDNJ ka vlerësuar se vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të merren parasysh. Këto vonesa mund të shkaktohen ose nga autoritetet gjyqësore ose nga autoritetet administrative. Shkaqe të kësaj natyre në jurisprudencën e GJEDNJ janë vënë në dukje si p.sh.: bashkimi i gabuar i disa çështjeve që ka shkakuar vonesa të panevojshme, shtyrjet e pabazuara në ligj të seancave gjyqësore, pezullimi i kundërligjshëm i procesit gjyqësor, vonesat nga ana e agjencive publike ligjzbatuese të shtetit në dorëzimin e provave të kërkuara nga gjykata, transferimi i çështjeve penale nga një gjykatë në tjetrën, mbajtja e seancave të apelimeve. (*Shih vendimin Eëing kundër Mbretërisë së Bashkuar*)

17. Në çështjen objekt gjykimi Kolegji konstaton se nuk është vendi për të marrë në shqyrtim kërkesën pasi, çështja është planifikuar për t’u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit për në datë 02.11.2022, në dhomë këshillimi. Kolegji vlerëson se çështja me objekt shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave ka mbetur pa objekt. Në këto kushte, gjykimi i kësaj kërkesë në Gjykatën e Lartë duhet të pushohet. Kolegji sjell në vëmendje pikën 3 të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon

se “3. Në rast se gjatë shqyrtimit të kërkesës organi që po kryen veprimet, ndërmerr hapat që po kërkohen nga pala, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, pushon shqyrtimi i kërkesës.”.

18. Për sa më sipër, Kolegji çmon se duhet të vendoset pushimin i kërkesës, pasi çështja është caktuar për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Bazuar në nenin 399/7, pika 3 të Kodit të Procedurës Civile

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të çështjes mbi kërkesën e kërkuesve Jorgo Zaro dhe Enida Zaro

Tiranë me 01.11.2022